

Ftesë për Ofertë (FO)

Akomodimi, sallat e konferencave, shujtat dhe pijet gjatë punëtorive

Helvetas Kosova fton palët e interesuara që të ofrojnë shërbimet e përshkruara më poshtë.

1. Përshkrimi i kontratës

Qëllimi i përgjithshëm i Helvetas - Kosovë është zbatimi i projekteve zhvillimore (Decentralizimi dhe Mbështetja e Komunave - DEMOS dhe Rritja e Punësimit për të Rinj - EYE) në Kosovë duke synuar përmirësimin e ekonomisë vendore dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve të Kosovës. Gjatë zbatimit të projekteve, Helvetas - Kosovë do të organizojë punëtori në rajone të ndryshme të Kosovës, prandaj, ekziston nevoja që të lidhet një kontratë kornizë me të paktën dy hotele për rajon.

Kjo FO ndahet në 4 lloje sipas regjioneve:

Lot#1 – Rajoni i Prishtines, **Lot#2** - Rajoni i Gjilanit, **Lot#3** Rajoni i Gjakoves, **Lot#4** Rajoni i Pejes, **Lot#5** Prizren

Ofertuesit lejohen të dërgojnë ofertat e tyre për një ose më shumë lloje. Detajet e shërbimeve të kërkuara janë shpjeguar në këtë dokument.

2. Afati kohorë

	DATA	ORA - CET
Shpallje tenderi	Nga 01 Mars 2023	-
Afati i fundit për pyetjet me shkrim ne procurement.kosovo@helvetas.org .	10 Mars 2023	16:00
Data e fundit për Helvetas – Kosovë për të dhënë sqarime, përmes web faqe te Helvetas	13 Mars 2023	16:00
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave ¹	17 Mars 2023	14:00

3. Natyra e kontratës

Kontratë kornizë

4. Negociatat

Helvetas - Kosovë ruan të drejtën për të hyrë në negociata me të gjithë ose me një pjesë të ofertuesve të pranueshëm, në mënyrë që të ndryshojnë dhe/ose plotësojnë ofertat e tyre origjinale.

Negociatat mund zhvillohen në lidhje me aspektet teknike, financiare, ligjore dhe aspektet tjera të kontratës.

5. Pranueshmëria

Pjesëmarrja është e hapur për të gjitha subjektet juridike të regjistruara në Republikën e Kosovës, duke mos përfshirë autoritetet publike.

NUK mund të aplikojnë të gjitha subjektet e pranueshme ose grupimet (konzorciumet) e subjekteve të tilla.

6. Kostot për përgatitjen e ofertës

Asnjë kosto e shkaktuar nga ofertuesi, gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të ofertave, nuk rimbursohet. Kostot e tilla bien nën përgjegjësinë e ofertuesit, duke përfshirë kostot e shkaktuara gjatë procesit të

¹ Çdo aplikacion i dorëzuar pas këtij afati nuk do të merret parasysh.

negocimit dhe intervistimit.

7. Nën-kontraktimi

Nuk lejohen shërbimet e nën-kontraktimit tek një person tjetër juridik.

8. Data e përkohshme e fillimit të kontratës

Prill 2023

9. Periudha fillestare e ekzekutimit të kontratës dhe zgjatja e mundshme e saj

Shërbimet do të ofrohen gjatë periudhës Prill 2023 - Mars 2024, me mundësi zgjatjeje deri në fund të vitit 2025.

10. Vlerësimi i ofertave

Secila ofertë do të vlerësohet në përputhje me kriteret dhe peshimin e detajuar më poshtë. Kriteret për vlerësimin e shërbimeve do të shqyrtohen në përputhje me kërkesat e paraqitura në shtojca.

E tërë procedura e vlerësimit është konfidenciale. Vendimet e Panelit Blerës (PB) janë kolektive dhe diskutimet e tij mbahen në seanca me dyer të mbyllura. Anëtarët e PB janë të detyruar të ruajnë fshehtësinë. Raportet e vlerësimit dhe shënimet me shkrim janë vetëm për përdorim zyrtar dhe nuk mund t'i komunikohen ofertuesve ose ndonjë pale tjetër përveç Helvetas - Kosovë.

10.1 Kriteret e pranueshmërisë

Kushtet/kërkesat	Dëshmitë e dokumentuara
1. Formulari për aplikim (Pjesa 1 e këtij dokumenti)	Formulari i nënshkruar i aplikimit
2. Ofertuesi të jetë i regjistruar në Kosovë	Certifikatën e plotë të Regjistrimit
3. Numri i TVSH-së	Certifikatën e TVSH-së (nëse kompania është e regjistruar në TVSH)
4. qarkullimi i përgjithshëm i kompanisë/organizatës gjatë 3 viteve të fundit (2020, 2021 dhe 2022) duhet të jetë i barabartë ose mbi EUR 100,000.00	Pasqyrat financiare ose verifikimin e qarkullimit nga ATK dhe/ose Banka
5. Ofertuesi nuk duhet të ketë raste të hapura për ndonjë kontest, ndonjë procedurë përmbarimi, procedurë riorganizimi, falimentimi ose paaftësie paguese	Një dëshmi valide të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor ose administrativ (jo më të vjetër se 6 muaj)
6. Duhet t'i ketë të gjitha tatimet të paguara	Një certifikatë valide të administratës tatimore ose një marrëveshje valide të nënshkruar me Administratën Tatimore të Kosovës për të shlyer borxhet e papaguara

Ofertuesit që përmbushin kriteret e pranueshmërisë do të procedohen për vlerësim të mëtutjeshëm.

10.2 Kriteret e vlerësimit të ofertave të pranueshme

Kriteret për vlerësimin e ofertës teknike

Kushtet/kërkesat	Dëshmitë e dokumentuara
1. Së paku 25 dhoma për akomodim	Dokument/broshure që përshkruan kapacitetin e hotelit
2. Sallë për konferenca me kapacitet prej 10 deri në 50 persona	Dokument/broshure që përshkruan sallat e konferencave
3. Sallë për konferenca me kapacitet prej 50 deri në 100 persona	Dokument/broshure që përshkruan sallat e konferencave
4. Shujtë me tri pjata (sallatën ose supën, ushqimin kryesor dhe ëmbëlsirën, plus një pije freskuese)	Dokument që përshkruan menynë (tri zgjedhje të menysë)

Ofertuesit që kalojnë vlerësimin Teknik (**Përgjigje pozitive** në të gjithë artikujt/specifikimet teknike) do të procedohen për vlerësim të mëtutjeshëm.

Kriteret për vlerësimin e ofertës financiare:

Kushtet/kërkesat	Dëshmitë e dokumentuara
Ofertë financiare sipas udhëzimeve në PJESEN 2 të këtij dokumenti	Ofertë financiare në EURO

Peshimi i kriterëve për vlerësimin e ofertave teknike dhe financiare është si në vijim:

Kriteret	PO/JO
Oferta teknike	PO/JO
Oferta financiare, shuma marre nga dokumenti i paraqitur ne PJESEN 2	Kostoja totale (shuma e njësive)
Të gjitha specifikimet e artikujve/shërbimeve ose të punëve	Çmimi më i ulët

Pas vlerësimit të ofertave, Helvetas - Kosovë ruan të drejtën për të hyrë në negociata me të gjithë ose me një pjesë të ofertuesve të pranueshëm, në mënyrë që të ndryshojnë dhe/ose plotësojnë ofertat e tyre origjinale.

Kontrata do të jepet për ofertën më të favorshme ekonomikisht. Oferta më e favorshme ekonomikisht përcaktohet përmes arritjes së cilësisë teknike sipas specifikimeve teknike me shumen me te ulet te çmimeve. Helvetas - Kosovë ruan të drejtën për të kontraktuar vetëm një pjesë të shërbimeve të kërkuara ose të anulojë këtë procedurë tenderi, nëse nuk është e kënaqur me cilësinë e ofertave.

11. Dorëzimi i ofertave

Ofertat duhet të dorëzohen me email në dy dosje elektronike të veçanta, duke përdorur udhëzimet e dhëna nga Helvetas Kosovo.

1. Oferta Teknike

- Formulari i nënshkruar i aplikimit (Pjesa 1 e ketije dokumenti)
- Certifikatën e plotë të Regjistrimit
- Certifikatën e TVSH-së (nëse kompania eshte e regjistruar ne TVSH)
- Pasqrat financiare ose verifikimin e qarkullimit nga ATK dhe/ose Banka
- Një dëshmi valide të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor ose administrativ (jo më të vjetër se 6 muaj)

- Një certifikatë valide të administratës tatimore ose një marrëveshje valide të nënshkruar me Administratën Tatimore të Kosovës për të shlyer borxhet e papaguara
2. Oferta financiare duke përdorur PJESËN 2 (*e cila duhet të mbrohet me fjalëkalim*)

Emri i dosjeve duhet të ketë **emrin e hotelit**, Nr. e Referencës: **NT-0016-CST** dhe dhe numrin e **Lot-it**:

- Për dosjen e ofertës teknike (**HOTEL XXXX NT-0016-CST LOT#X**)
- Për dosjen e ofertës financiare, (**HOTEL XXXX NT-0016-CST LOT#X- Oferta Financiare**).

Oferta financiare duhet të mbrohet me fjalëkalim². Ofertuesit do të informohen paraprakisht pasi të konfirmohet data e vlerësimit në mënyrë që ata të jenë të qasshëm në atë datë në mënyrë që të ofrojnë fjalëkalimet. Gjatë procesit të vlerësimit, anëtar i autorizuar i panelit të blerjes do të telefonojë ofertuesin dhe do të kërkojë fjalëkalimin aty për aty³.

Subjekti i emailit duhet të përmbajë vetëm numrin e referencës (**NT-0016-CST**).

Teksti kryesor i emailit duhet të përmbajë emrin zyrtar, adresën dhe numrin e telefonit të ofertuesit.

Oferta teknike dhe ofertat financiare duhet të dorëzohen ekskluzivisht në gjuhën angleze ose Shqipe në emailin si në vazhdim: procurement.kosovo@helvetas.org.

Ofertat e dorëzuara pas afatit të përmendur në pikën 2 të kesaj FO, nuk do të merren parasysh. Koha e llogaritur e pranimit zyrtar është koha që tregohet në emailin e pranuar nga ofertuesi në procurement.kosovo@helvetas.org.

12 Ndryshimi ose tërheqja e aplikacioneve

Kandidatët mund të ndryshojnë ose tërheqin ofertat e tyre me njoftim me shkrim para afatit të fundit për dorëzimin e ofertave. Asnjë ofertë nuk mund të ndryshohet pas këtij afati.

Helvetas - Kosovë ruan pronësinë e të gjitha ofertave që nuk janë tërhequr. Rrjedhimisht, ofertuesit nuk kanë të drejtën e kthimit të ofertës tek ta.

13 Vlefshmëria e ofertave

Ofertuesit janë të lidhur me tenderët e tyre për 90 ditë pas afatit për dorëzimin e ofertave. Në raste të jashtëzakonshme, para skadimit të periudhës së vlefshmërisë, Helvetas - Kosovë mund të kërkojë nga ofertuesit që të zgjasin periudhën e vlefshmërisë për një numri të caktuar ditësh, e cila nuk mund të kalojë 40 ditë.

14 Nënshkrimi i kontratës(-ave)

Brenda 7 ditëve nga pranimi i kontratës tashmë të nënshkruar nga Helvetas - Kosovë, ofertuesi i përzgjedhur nënshkruan dhe shënon datën e kontratës. Mos-respektimi i kësaj kërkesë nga ofertuesi mund të përbëjë arsye për anulimin e vendimit për të dhënë kontratën. Në këtë rast, Helvetas - Kosovë mund t'ia japë tenderin një ofertuesi tjetër ose të anulojë procedurën e tenderit.

15 Kushtet e pagesave

Helvetas - Kosovë nuk është pague e tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së). Çmimet në aplikacion duhet të dorëzohen duke marrë parasysh të gjitha shpenzimet.

² Ofertat financiare të pranuar pa mbrojtje me fjalëkalim nuk do të merren parasysh për vlerësim.

³ Nëse ofertuesi nuk është i qasshëm në telefon gjatë procesit të vlerësimit, ofertat nuk do të konsiderohen për vlerësim.

Pagesa do të bëhet përmes transferit në llogari bankare tek fituesi i tenderit, në EURO, brenda një afati maksimal prej 30 ditë pune nga data e pranimit të mallrave ose ekzekutimi i shërbimeve ose punëve. Rastet e mos kryerjes së obligimeve dhe pasojat e tyre ligjore do të paraqiten veçmas në kontratë.

16 Kushtet e bashkëpunimit

Në rast të një kontraktimi, palët do të duhet të kryejnë punët e tyre sipas kohës së përcaktuar dhe në përputhje me Helvetas-Kosovë – Urdhër blerja e furnizuesit ose Helvetas-Kosovë - Kontrata e ofruesit të shërbimeve. Helvetas-Kosovë ka të drejtë të rrisë ose zvogëlojë numrin e artikujve të porositur. Helvetas-Kosovë ka të drejtë të përzgjedhë një furnizues/zbatues në ofertën e dhënë nën diskrecionin e tij. Helvetas-Kosovë ka të drejtë të riformulojë Kërkesën për Kuotim (KpK), Ftesën për Ofertë (FO) ose Kërkesën për Propozim (KpP) nën diskrecion të tij, nëse nevojitet ndonjë artikull shtesë. Në rast të dështimit ose mos-përmbyshjes së detyrimeve kontraktuale, Helvetas-Kosovë ka një të drejtë të njëanshme për të ndërprerë kontratën pa pësuar ndonjë detyrim ligjor.

Aplikuesi duhet të jetë i njohur me të gjitha udhëzimet, formularët dhe kërkesat e përmendura në dokumentet e KpK, FO ose KpP. Përgjegjësia për dorëzimin e ofertës në përputhje me këto kërkesa i takon tërësisht aplikuesit.

Helvetas-Kosovë nënshkruan një urdhër blerje/kontratë me ofertuesin fitues. Kontrata do të hyjë në fuqi pas nënshkrimit nga të dyja palët.

17 Klauzolat e etikës/praktikat korruptive

Ofertuesit që bëjnë deklaratat të rrejshme mund t'i nënshtrohen ndëshkimeve financiare që përfaqësojnë 10% të vlerës totale të urdhër blerjes/kontratës që i jepet. Kjo normë mund të rritet deri në 20% në rast të shkeljes së përsëritur.

Çdo përpjekje nga një kompani/organizatë për të marrë informata konfidenciale, për të hyrë në marrëveshje të paligjshme me konkurrentët ose për të ndikuar tek PP ose Helvetas-Kosovë gjatë procesit të shqyrtimit, sqarimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave do të çojë në refuzimin e ofertës së tyre dhe mund të rezultojë në ndëshkimet e përshkuara më sipër.

Kompanitë/organizatat nuk duhet të ndikohen nga ndonjë konflikt interesi me ofertuesit tjerë ose palët e përfshira në projekt. Helvetas - Kosovë ruan të drejtën për të pezulluar ose anuluar procedurën e KpK dhe/ose urdhër blerjen/kontratën nëse zbulohen praktika korruptive të çfarëdo lloji në çfarëdo faze të procesit të dhënies ose gjatë ekzekutimit të një kontrate.

Kompanitë/organizatat do të refuzohen ose do t'u ndërpritet urdhër blerja/kontrata nëse del se dhënia ose ekzekutimi i një kontrate ka shkaktuar shpenzime të pazakonta komerciale. Shpenzimet e tilla të pazakonta komerciale janë komisionet e papërmendura në kontratën kryesore ose që nuk rrjedhin nga një kontratë e lidhur siç duhet që i referohet kontratës kryesore, komisionet që nuk paguhen në këmbim të ndonjë shërbimi aktual dhe legjitim, komisionet që transferohen tek një strehë tatimore, komisionet që i paguhen një pranuesi i cili nuk është i identifikuar qartë ose komisionet e paguara për një kompani/organizatë që ka çdo tipar të të qenit një kompani/organizatë guaskë.

Kontraktuesit që vërehen se kanë paguar shpenzime të pazakonta komerciale që lidhen me këtë projekt, do të jenë subjekt i ndërprerjes së kontratës dhe/ose do të ndëshkohen, varësisht nga serioziteti i fakteve të vërejtura.

Helvetas-Kosovë ruan të drejtën për të pezulluar ose anuluar procedurën, kur dëshmohet se procedura e dhënies së kontratës ka qenë subjekt i gabimeve, parregullsive ose mashtrimeve substanciale. Nëse zbulohen gabime, parregullsi ose mashtrime substanciale pas dhënies së urdhër-blertes/kontratës, Helvetas-Kosovë mund të përmbahet nga lidhja e urdhër blerjes/kontratës dhe/ose

të ndërpresë urdhër blerjen/kontratën.

18 Gjuha operative

Të gjitha komunikimet me shkrim për këtë procedurë tenderi dhe urdhër blerja/kontrata duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe angleze.

19 Informacione shtesë

Përmbyllja e tenderit dhe dhënia e urdhër blerjes/kontratës i nënshtrohen disponueshmërisë së fondeve.

Helvetas-Kosovë ruan të drejtën për të anuluar këtë procedurë tenderi në çdo kohë, pa ndonjë detyrim për të.

PJESA 1 – PAKOJA E APLIKACIONIT**FORMULARI PËR APLIKIM****1 PARASHTRUAR nga (d.m.th. identiteti i ofertuesit)**

Emri(-at) i subjektit(-eve) që aplikon

2 PERSONI KONTAKTUES (për këtë aplikacion)

Emri	
Organizata	
Adresa	
Telefoni	
Email	

3 DEKLARATA⁴

Unë, i nënshkruari, nënshkruesi i autorizuar i ofertuesit të mësipërm (për konzorciumet, **çdo anëtar i konzorciumit duhet ta nënshkruajë një deklaratë të veçantë si pjesë e këtij aplikacioni**), deklaroj se kam shqyrtuar dosjen e tenderit për kontratën e referuar më sipër. Nëpërmjet kësaj, ne pranojmë plotësisht dispozitat e tij, pa asnjë rezervë apo kufizim.

Ne pranojmë që të bëhemi njëra nga palët e kontratës kornizë dhe që të paraqesim ofertë kurdo që kërkohet nga Helvetas Kosova, në përputhje me termat e dosjes së tenderit dhe kushtet e përcaktuara, pa asnjë rezervë apo kufizim.

Ne po aplikojmë për këtë tender në bazë të vullnetit tonë. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për kontratën e njëjtë në asnjë formë tjetër. Ne e kuptojmë që konsulentët tonë mund të përjashtohen, nëse propozojmë konsulentë të cilët kanë qenë të përfshirë në oferta të ofertuesve tjerë.

Ne jemi plotësisht të vetëdijshëm se, për konzorciumet, përbërja e konzorciumit nuk mund të ndryshohet në vazhden e procedurës së tenderimit, përveç nëse Helvetas-Kosovë ka dhënë miratim paraprak me shkrim. Ne po ashtu jemi të vetëdijshëm që anëtarët e konzorciumit kanë disa përgjegjësi të përbashkëta ndaj Helvetas-Kosovë lidhur me pjesëmarrjen në procedurën e tenderit të mësipërm dhe çdo kontratë që na jepet si rezultat i saj.

Ne do ta informojmë menjëherë Helvetas-Kosovë nëse rrethanat e mësipërme ndryshojnë në ndonjë fazë gjatë zbatimit të kontratës. Ne po ashtu njohim dhe pranojmë plotësisht që çdo informacion i pasaktë dhe jo i plotë i ofruar në mënyrë të qëllimshme në këtë aplikacion mund të rezultojë në përjashtimin tonë nga

⁴ Deklarata duhet të nënshkruhet nga secili anëtar i konzorciumit, nëse është konzorcium.

kjo kontratë dhe kontratat tjera të financuara dhe/ose menaxhuara nga Helvetas-Kosovë dhe që mund të zbatohen sanksione siç specifikohet në dosjen e tenderit.

Ne kemi vërejtur se Helvetas-Kosovë nuk është e detyruar të vazhdojë me këtë tender dhe se ruan të drejtën për të ofruar vetëm një pjesë të kontratës, dhe se nuk do të shkaktojë kurrfarë detyrimi ndaj nesh, nëse veprohet në mënyrë të tillë.

Nënshkruar në emër të ofertuesit

Emri	
Nënshkrimi	
Data	

PJESA 2 - OFERTA FINANCIARE
Oferta financiare

Helvetas-Kosovë është e liruar nga TVSH-ja, rrjedhimisht kostoja duhet të jetë pa TVSH. Kontraktuesi është përgjegjës për të gjitha tarifat dhe taksat tjera në përputhje me Ligjet e Republikës së Kosovës.

Artikujt – specifikimet	Sasia	Njësia e çmimit / Euro	Totali
<i>Dhomë njëshe, përfshirë mëngjesin</i>	1		
<i>Dhomë dyshe, përfshirë mëngjesin</i>	1		
<i>Sallë konferencash me kapacitet prej 10 deri në 50 persona – tërë ditën</i>	1		
<i>Sallë konferencash me kapacitet prej 10 deri në 50 persona – gjysmë dite</i>	1		
<i>Sallë konferencash me kapacitet prej 50 deri në 100 persona – tërë ditën</i>	1		
<i>Sallë konferencash me kapacitet prej 50 deri në 100 persona – gjysmë dite</i>	1		
<i>Shujtë me tri pjata (sallatë ose supë, pjata kryesore dhe ëmbëlsirë, si dhe një pije joalkoolike) – lloji i parë</i>	1		
<i>Shujtë me tri pjata (sallatë ose supë, pjata kryesore dhe ëmbëlsirë, plus një pije freskuese) – lloji i dytë</i>	1		
<i>Shujtë me tri pjata (sallatë ose supë, pjata kryesore dhe ëmbëlsirë, plus një pije freskuese) – lloji i tretë</i>	1		
<i>Ujë gjatë punëtorive, shishe e vogël</i>	1		
<i>Ujë gjatë punëtorive, shishe e madhe</i>	1		
<i>Kafe/çaj gjatë pushimeve për secilin person</i>	1		
Kostoja totale (shuma e njësive)			

Nënshkruar në emër të ofertuesit

Emri	
Nënshkrimi	
Data	